



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) Nr. 06/2020  
PËR PROCEDURËN DHE KRITERET E PËRCAKTIMIT TË STATUSIT TË PERSONIT PA SHTETËSI,  
MËNYRA E FITIMIT TË SHTETËSISË PËR PERSONIN PA SHTETËSI DHE PERSONIN ME STATUS TË  
REFUGJATIT**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MIA) No.06/2020  
FOR THE PROCEDURE AND CRITERIA OF DETERMINING THE STATUS OF THE STATELESS PERSON, THE  
MANNER OF ACQUISITION OF THE CITIZENSHIP BY THE STATELESS PERSON AND THE PERSON WITH  
REFUGEE STATUS**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MUP) Br. 06/2020  
O POSTUPKU I KRITERIJUMIMA ZA UTVRĐIVANJE STATUSA LICA BEZ DRŽAVLJANSTVA, NAČINU  
STICANJA DRŽAVLJANSTVA ZA LICA BEZ DRŽAVLJANSTVA I LICA SA STATUSOM IZBEGLICA**

<p><b>Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme,</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 15, të Ligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës (GZ nr. 33, më datë 02.09.2013), nenit 8, nënparagrafin 1.4 të Rregullores nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15, 12.09.2011),</p> <p>Nxjerr:</p> <p style="text-align: center;"><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR.06/2020 PËR PROCEDURËN DHE KRITERET E PËRCAKTIMIT TË STATUSIT TË PERSONIT PA SHETËSI, MËNYRËN E FITIMIT TË SHETËSISË PËR PERSONIN PA SHETËSI DHE PERSONIN ME STATUS TË REFUGJATI</b></p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave dhe kriterëve për</p>	<p><b>Minister of the Ministry Internal Affairs,</b></p> <p>Pursuant to article 15, of Law No. 04/L-215 on Citizenship of Kosovo (OG No.33, dated 02.09.2013), article 8, sub-paragraph 1.4 of Regulation No.06/2020 for the Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries, as well as article 38, paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government No. 09/2011 (Official Gazette No.15, 12.09.2011),</p> <p>Issues:</p> <p style="text-align: center;"><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MIA) NO. 06/2020 FOR THE PROCEDURE AND CRITERIA OF DETERMINING THE STATUS OF THE STATELESS PERSON, THE MANNER OF ACQUISITION OF THE CITIZENSHIP BY THE STATELESS PERSON AND THE PERSON WITH REFUGEE STATUS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>The purpose of this Administrative Instruction is to establish the procedures and criterias for</p>	<p><b>Ministar Ministarstva Unutrašnjih Poslova,</b></p> <p>Na osnovu člana 15, Zakona br. 04/L-215 o Državljanstvu Kosova (Sl. list br. 33, od 02.09.2013), člana 8. tačka 1.4 Pravilnika br. 06/2020 o Oblastima Administrativne Odgovornosti Kabineta Premijera i Ministarstava, kao i člana 38. stav 6. Poslovnika o Radu Vlade br. 09/2011 (Sl. list br. 15, od 12.09.2011),</p> <p>Donosi:</p> <p style="text-align: center;"><b>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MUP) BR. 06/2020 O POSTUPKU I KRITERIJUMIMA ZA UTVRĐIVANJE STATUSA LICA BEZ DRŽAVLJANSTVA, NAČINU STICANJA DRŽAVLJANSTVA ZA LICA BEZ DRŽAVLJANSTVA I LICA SA STATUSOM IZBEGLICA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1 Svrha</b></p> <p>Svrha ovog Administrativnog uputstva je da se uspostavi postupak i kriterijumi za</p>
--	--	--

<p>njohjen e statusit të personit pa shtetësi, të drejtat e personit pa shtetësi, si dhe mënyra e fitimit të shtetësisë për personin me status të pa shtetësisë dhe personit me status të refugjati në Republikën e Kosovës.</p>	<p>determining the status of the stateless person, rights of stateless person and the manner of citizenship acquisition by stateless person and person with refugee status in the Republic of Kosovo.</p>	<p>utvrđivanje statusa lica bez državljanstva, prava lica bez državljanstva, kao i sticanje državljanstva za lica bez državljanstva i lica sa statusom izbeglice u Republici Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug</b></p>
<p>Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të detyrueshme për të gjithë zyrtarët përgjegjës në DSH/DSHAM si dhe për të gjithë personat me status te personit pa shtetësi dhe personat me status refugjati në Republikën e Kosovës.</p>	<p>The norms of this Administrative Instruction are mandatory for all responsible officials in DC/DCAM as well as for all persons with stateless and refugee status in Republic of Kosovo.</p>	<p>Odredbe ovog Administrativnog uputstva su obavezne za sve službenike DD/DDAM kao i za lica sa statusom lica bez državljanstva i statusom izbeglice u Republici Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 Definitions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p>
<p>1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin si në vijim:</p>	<p>1. Expressions, terms and abbreviations used in this Administrative Instruction have the following meaning:</p>	<p>1. Izrazi, terminologija i skraćenice upotrebljene u ovom Administrativnom Uputstvu imaju sledeće značenje:</p>
<p>1.1. <b>“MPB”</b> nënkupton Ministrinë e Punëve të Brendshme;</p>	<p>1.1. <b>“MIA”</b> means Ministry of Internal Affairs;</p>	<p>1.1. <b>„MUP“</b> znači Ministarstvo Unutrašnjih Poslova;</p>
<p>1.2. <b>“DSHAM”</b> nënkupton Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion;</p>	<p>1.2. <b>“DCAM”</b> means Department for Citizenship, Asylum and Migration;</p>	<p>1.2. <b>„DDAM“</b> znači Departman za Državljanstvo, Azil i Migraciju;</p>
<p>1.3. <b>“DSH”</b> nënkupton Divizionin e Shtetësisë;</p>	<p>1.3. <b>“DC”</b> means Division for Citizenship;</p>	<p>1.3. <b>„DD“</b> znači Diviziju za Državljanstvo;</p>
<p>1.4. <b>“Person pa shtetësi”</b> nënkupton ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Shtetësi;</p>	<p>1.4. <b>“Stateless person”</b> means as determined by the Law on Citizenship;</p>	<p>1.4. <b>„Lice bez državljanstva“</b> znači kao u skladu sa Zakonom o Državljanstvu;</p>

<p>1.5. <b>“Person refugjat”</b> nënkupton ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Azil;</p> <p>1.6. <b>“Zyrtari përgjegjës”</b> nënkupton Zyrtarin në DSH-DSHAM që shqyrton kërkesën;</p> <p>1.7. <b>“Anëtar i familjes”</b> nënkupton fëmijë i mitur të pa martuar dhe bashkëshorti/ja e personit me status refugjati ose personit pa shtetësi.</p> <p>1.8. <b>“Banim i përshtatshëm”</b> nënkupton sipërfaqen e banimit të nevojshëm për banorët, duke plotësuar dispozitat e veçanta për normat minimale të banimit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin ashtu siç janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës të kësaj fushe.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI II PROCEDURA PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË PERSONIT PA SHTETËSI</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Nen 4 Kërkesa për njohjen e statusit të personit pa shtetësi</b></p>	<p>1.5. <b>“Refugee person”</b> means as determined by the Law on Asylum.</p> <p>1.6. <b>“Responsible Officer”</b> means the DCAM/DC Officer who reviews the request.</p> <p>1.7. <b>“Family member”</b> means an unmarried minor child, and the spouse of a refugee or a stateless person.</p> <p>1.8. <b>“Adequate residence”</b> means the living space necessary for the residents, by fulfilling specific provisions for the minimum residence standards in accordance with to the relevant legislation in force.</p> <p>2. The other expressions, terms and abbreviations used in this Administrative Instruction shall have the meaning as set forth in the Law on Citizenship of Kosovo and in the relevant legislation in this field.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER II PROCEDURES FOR THE DETERMINATION OF STATELESS PERSON STATUS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4 The submission of the request for recognition of status of stateless person</b></p>	<p>1.5. <b>„Izbeglo lice“</b> znači onako kako je predviđeno u Zakonu o Azilu;</p> <p>1.6. <b>„Odgovorni službenik“</b> znači službenik DD-DDAM-a koji razmatra zahtev;</p> <p>1.7. <b>„Član porodice“</b> označava maloletno nevenčano lice i supruga/u lica sa statusom izbeglice ili lica bez državljanstva;</p> <p>1.8. <b>„Adekvatno stanovanje“</b> podrazumeva stambeni prostor potreban za stanovnike, kako bi se ispunile posebne odredbe za minimalne norme stanovanja u skladu sa relevantnim važećim zakonodavstvom.</p> <p>2. Ostali pojmovi, termini i skraćenice koje se upotrebljavaju u ovom Administrativnom uputstvu imaju značenja koja su utvrđena u Zakonu o državljanstvu Kosova i relevantnom zakonodavstvu u ovoj oblasti.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE II PRISTUP POSTUPCIMA ZA UTVRĐIVANJE STATUSA LICA BEZ DRŽAVLJANSTVA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4 Podnošenje zahteva za priznavanje statusa osobe bez državljanstva</b></p>
---	---	--

<p>1. Kërkesa për njohjen e statusit të personit pa shtetësi parashtrohet personalisht nga parashtruesi i kërkesës në DSH/DSHAM me të gjitha dokumentet që ai i posedon.</p> <p>2. Kërkesës sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet bashkangjitur edhe fotografija e parashtruesit të kërkesës të paraqitura në formularin sipas shtojcës 1.</p> <p>3. DSH /DSHAM, mund të kërkoj nga Policia e Kosovës/Drejtoria për Migrim dhe të Huaj, marrjen e gjurmëve të gishtërinjëve.</p> <p>4. Kërkesa regjistrohet në bazën e të dhënave të DSHAM-së.</p> <p>5. Në rastet kur parashtruesi i kërkesës është fëmijë apo person me aftësi të kufizuara mendore, atëherë parashtrimin e kërkesës e bën prindi ose përfaqësuesi ligjor i tij sipas shtojcës 1.</p> <p>6. Me qëllim të plotësimit të kërkesës DSH/DSHAM e siguron përkthyesin në njërën nga gjuhët të cilën e kupton parashtruesi i kërkesës nga lista e përkthyesëve të MPB-së. Përkthyesi nënshkruan deklaratën për mungesë të konfliktit të interesit dhe ruajtjen e sekretit profesional, sipas shtojcës 2.</p> <p>7. DSH/DSHAM i lëshon një dëshmi</p>	<p>1.The request for recognition of the status of stateless persons is submitted personally by applicant to DCAM/DC with all documents he/she is disposing with.</p> <p>2. A photo of the applicant shall be submitted jointly with the request in accordance with the paragraph 1 and annex 1.</p> <p>3. DC/DCAM, may request from Kosovo Police/Department for Migration and Foreigners to take fingerprints.</p> <p>4. The request is registered in the DCAM database.</p> <p>5. In cases when the applicant is a child or a person with mental disabilities, the submission of the request is made by the parent or legal representative in accordance with the annex 1.</p> <p>6. In order to complete the request the DC/DCAM provides the interpreter in one of the languages that the applicant understands, from the list of official interpreters of MIA. The interpreter signs the declaration of no conflict of interest and the professional confidentiality, in accordance with the annex 3.</p> <p>7. DC/DCAM, issues a certificate to the</p>	<p>1. Zahtev za priznavanje statusa lica bez državljanstva podnosi se lično od strane aplikanta u DD/DDAM, zajedno sa svim dokumentima koje on/ona poseduje.</p> <p>2. Prilikom podnošenja zahteva u skladu sa stavom 1 ovog člana, pored zahteva aplikant treba da preda i sliku prema aneksu 1.</p> <p>3. DD/DDAM, može zahtevati od Policije Kosova/Direkcije za migraciju i strance uzimanje otisaka prstiju.</p> <p>4. Zahtev se registruje u bazu podataka DDAM-a.</p> <p>5. U slučajevima kada je podnosilac zahteva dete ili mentalno zaostalo lice, onda podnošenje zahteva vrši roditelj ili zakonski zastupnik prema aneksu 1.</p> <p>6. U cilju popunjavanja zahteva DD/DDAM obezbeđuje prevodioca na jednom od jezika koji podnosilac zahteva razume, sa spiska prevodioca MUP-a. Prevodilac potpisuje izjavu da nije u sukobu interesa i da će sačuvati profesionalnu tajnu prema aneksu 3.</p> <p>7. DD/DDAM izdaje podnosiocu zahteva</p>
--	---	---

<p>parashtruesit të kërkesës për dorëzimin e aplikacionit sipas shtojcës 3.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Dokumentet për aplikim</b></p> <p>1. Aplikuesi me rastin e paraqitjes së kërkesës për përcaktimin e statusit të personit pa shtetësi, nëse i posedon, duhet bashkëngjitur njëzën nga dokumentet si në vijim:</p> <p>1.1. certifikata e lindjes apo ndonjë dokument tjetër ekuivalent;</p> <p>1.2. dëshmi e lëshuar nga spitali pas lindjes;</p> <p>1.3. dokument udhëtimi (përfshirë edhe ato me afat të skaduar);</p> <p>1.4. certifikatën e martesës;</p> <p>1.5. dëshmi të shërbimit ushtarak;</p> <p>1.6. dëshmi të shkollës;</p> <p>1.7. dokument identifikimi ose udhëtimi të prindërve, bashkëshortit ose fëmijëve;</p> <p>1.8. dokumentet e imigrimit apo leje e vendbanimit të shtetit të mëhershëm të vendbanimit;</p>	<p>applicant for submission of the request, in accordance with annex 3.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Documents for application</b></p> <p>1. Applicant, upon submission of the request for determination of the status of the stateless person, shall attach one of the following evidences, if available:</p> <p>1.1. birth certificate or other equivalent document;</p> <p>1.2. certificate issued by the hospital after the birth;</p> <p>1.3. travel document (including the expired one);</p> <p>1.4. marriage certificate;</p> <p>1.5. proof of military service;</p> <p>1.6. evidence of schooling;</p> <p>1.7. spouse's, parent's or children's identification or travel documents;</p> <p>1.8. immigration documents or residence permit from the previous state of residence;</p>	<p>potvrdu o podnošenju zahteva prema aneksu 3.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Dokumenti za predavanje zahteva</b></p> <p>1. Predavalac prilikom podnošenja zahteva za utvrđivanje statusa lica bez državljanstva treba priložiti jedan od sledećih dokaza ako raspolaže sa istima:</p> <p>1.1. izvod rođenih ili neki drugi istovetni dokument;</p> <p>1.2. dokaz koji je izdala bolnica posle rođenja;</p> <p>1.3. putnu ispravu (uključujući i onu kojoj je isteklo važenje);</p> <p>1.4. izvod venčanih;</p> <p>1.5. dokaz o odsluženom vojnom roku</p> <p>1.6. dokaz o školovanju;</p> <p>1.7. identifikacione ili putne isprave roditelja, bračnog druga ili dece;</p> <p>1.8. dokumenta o imigraciji ili dozvolu boravka države u kojoj je aplikant prethodno imao/imala boravak;</p>
--	--	---

<p>1.9. një dokument apo dëshmi të lëshuar nga autoriteti i huaj që vërteton se personi nuk është shtetas i shtetit përkatës;</p> <p>1.10. dëshminë që nuk ka dosje penale lëshuar nga Policia e Kosovës dhe dëshminë që nuk është duke u zhvilluar procedur penale dhe nuk është i dënuar për vepra penale e lëshuar nga Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës dhe</p> <p>1.11. dokumente të tjera relevante;</p> <p>2. Në rast të pamundësisë për ofrimin e dëshmimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, DSH/DSHAM sipas <i>detyrës zyrtare</i> bën verifikimin dhe mbledh informatat apo dëshmi tjera të nevojshme.</p> <p>3. Në rastet kur gjatë kërkesës për përcaktimin e statusit të pa shtetësisë apo gjatë procedimit të mëtejshëm, vërehet se ekziston edhe një kërkesë azili, ose dyshimi se personi mund të jetë një azilkërkuës potencial apo i njëjti dyshohet se mund të jetë viktimë e trafikimit, procedura do të pezullohet dhe personi në fjalë do të referohet varësisht situatës së rastit.</p>	<p>1.9. a document or statement issued by a foreign authority certifying that the person is not a citizen of the concerned State;</p> <p>1.10. certificate which proves that he/she has no criminal offence record, issued by the Kosovo Police and evidence that there are no criminal proceedings ongoing and that he/she is not convicted for any criminal offence issued by the competent court of the Republic of Kosovo and</p> <p>1.11. other relevant documents;</p> <p>2. In case of inability to submit evidences listed in paragraph 1 of this Article, DCAM/DC shall <i>ex officio</i> verify and gather the necessary information or evidence.</p> <p>3. In cases when during the request for determining the stateless status of a person or during further proceedings, it is noted that an application for asylum has been made, or there is a doubt that the person could be a potential asylum seeker or the same is suspected to be a victim of trafficking, the procedures shall be suspended and the concerned person shall be referred accordingly with his or her situation.</p>	<p>1.9. dokumenat ili dokaz izdat od stranog nadležnog organa kojim se potvrđuje da to lice nije državljanin dotične države;</p> <p>1.10. potvrda da nema krivični dosije koje izdaje Policija Kosova i potvrda od nadležnog suda Republike Kosova da se protiv njega/nje ne sprovodi krivični postupak kao i da nije osudjen/a za neko krivično delo i</p> <p>1.11. druga relevantna dokumenta</p> <p>2. U slučaju da nije moguće pribaviti dokaze iz stava 1 ovog člana, DD/DDAM po službenoj dužnosti vrši proveru i prikupljanje potrebnih informacija ili dokaza.</p> <p>3. U slučajevima kada se u postupku utvrđivanja statusa lica bez državljanstva ili u toku dalje obrade zahteva utvrdi da postoji i zahtev za dobijanje azila ili postoji sumnja da je lice potencijalni tražilac azila ili se sumnja da isti može biti žrtva trgovine ljudima, postupak će se obustaviti i dotično lice biće upućeno u zavisnosti od situacije slučaja.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 6 Intervista</b></p> <p>1. Parashtruesit e kërkesës për përcaktimin e statusi të personit pa shtetësi duhet të intervistohen për të mbrojtur kërkesat e tyre.</p> <p>2. Intervistat planifikohen duke marrë parasysh kapacitetet e DSH/DSHAM-së lidhur me shqyrtimin e kërkesave për statusin e personit pa shtetësi.</p> <p>3. Intervistat me parashtruesit e kërkesës planifikohen të mbahen në afat brenda gjashtëdhjetë ditëve (60), që nga data e parashtrimit të kërkesës dhe ftohen sipas rradhës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6 Interview</b></p> <p>1. Applicants of requests for the status of stateless person, shall be interviewed to support their claim.</p> <p>2. Interviews shall be scheduled taking into account the capacity of the DC/DCAM regarding the review of requests for the status of stateless person.</p> <p>3. Interviews with applicants shall be scheduled within sixty (60) days from the date of request submission and will be invited in order.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6 Razgovora</b></p> <p>1. Sa podnosiocima zahteva za utvrđivanje statusa lica bez državljanstva obaviće se razgovor da bi obrazložili svoj zahtev.</p> <p>2. Razgovori se planiraju tako da se vodi računa o kapacitetu DD/DDAM vezano za razmatranje zahteva za status lica bez državljanstva.</p> <p>3. Razgovori sa podnosiocem zahteva prema planu će se obaviti u roku od šesdeset (60) dana od dana podnošenja zahteva i biće pozvani po redu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7 Informimi</b></p> <p>1. DSH-DSHAM njofton parashtruesin e kërkesës lidhur me të drejtat dhe detyrimet të cilave duhet t'iu përmbahet.</p> <p>2. Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet t'i ofrohet me shkrim parashtruesit të kërkesës në gjuhën të cilën e kupton ai. Kur është e nevojshme, ky informacion mund të jipet edhe verbalisht.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7 Information</b></p> <p>1. DC/DCAM will inform the applicant regarding the rights and obligations to comply with.</p> <p>2. Notification under paragraph 1 of this article shall be provided in a language the applicant understands. When necessary, this information can also be provided verbally.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7 Informisanje</b></p> <p>1. DD/DDAM će upoznati stranku sa njenim pravima i obavezama kojih treba da se pridržava.</p> <p>2. Obaveštavanje iz stava 1. ovog člana mora da se pruži podnosiocu zahteva na jeziku koji razume. Kad je to potrebno, takve informacije mogu se dati i usmeno.</p>



<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Organizimi i intervistës</b></p> <p>1. Pas plotësimit dhe dorëzimit të kërkesës sipas shtojcës 1, zyrtari përgjegjës organizon intervistën me parashtruesin e kërkesës.</p> <p>2. Ftesa për intervistë sipas paragrafit 1 të këtij neni, i dërgohet parashtruesit të kërkesës së paku katër (4) ditë para datës së paraparë të zhvillohet intervista.</p> <p>3. Zyrtari përgjegjës, lidhur me intervistën e paraparë, do t'i njoftoj edhe akterët e tjerë relevant.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Organizing the interview</b></p> <p>1. Upon completion and submission of the request according to annex 1, the case officer will organize an interview with the applicant.</p> <p>2. Invitation for the interview under paragraph 1 of this Article will be sent to the applicant at least four (4) days before the scheduled interview.</p> <p>3. The case officer will notify other relevant actors of the foreseen interview.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Organizovanje razgovora</b></p> <p>1. Posle popunjavanja i predaje zahteva prema aneksu 1, službenik zadužen za slučaj organizovaće razgovor sa podnosiocem zahteva.</p> <p>2. Poziv na razgovor iz stava 1 ovog člana poslaće se podnosiocu zahteva najmanje četiri (4) dana pre datuma predviđenog za obavljanje razgovora.</p> <p>3. Odgovorni službenik obavestiće i druge učesnike o zakazanom razgovoru.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Përgatitja e intervistës</b></p> <p>1. Para intervistës për përcaktimin e statusit të personit pa shtetësi, zyrtari përgjegjës shqyrton dosjen e parashtruesit të kërkesës e cila përfshinë:</p> <p>1.1. kërkesën sipas shtojcës 1;</p> <p>1.2. dokumentet, dëshmit, informatat dhe të dhënat tjera siç janë përcaktuara në nenin 5 të këtij udhëzimi administrativ;</p> <p>1.3. informatat nga vendi i origjinës, duke përfshirë hartat e territoreve, rajoneve të cekura në kërkesë, si dhe të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të shteteve përkatëse me të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Preparing the interview</b></p> <p>1. Before the interview for the determination of the stateless person status, the case officer shall make a thorough review of the file including:</p> <p>1.1. the request in accordance with annex 1;</p> <p>1.2. documents, evidences, information and any other data provided as defined under article 5 of this Administrative Instruction;</p> <p>1.3. Review of information from the country of origin, including maps of the territories, regions mentioned in the request, including all legal and sublegal acts of the respective</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Priprema za razgovor</b></p> <p>1. Pre razgovora za utvrđivanje statusa lica bez državljanstva, odgovorni službenik mora da prouči kompletan dosije, uključujući sledeće:</p> <p>1.1. zahtev prema ankesu 1;</p> <p>1.2. dokumente, dokaze, informacije i ostale podatke propisane u članu 5 ovog administrativnog uputstva;</p> <p>1.3. da prouči informacije dobijene iz zemlje porekla, uključujući mape teritorija i regiona navedenih u zahtevu, kao i sve zakone i podzakonske akte onih država sa kojima</p>

<p>cilat parashtruesi i kërkesës ka ndonjë lidhje;</p> <p>1.4. identifikimin e cilit do informacion i cili mungon, është i paqartë ose i papërputhshëm i siguruar nga parashtruesi i kërkesës, i cili më pas kërkohet për t'u shpjeguar nga ai.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Pjesëmarrësit në intervistë</b></p> <p>1. Intervista me parashtruesin e kërkesës do të zhvillohet nën kushte konfidenciale dhe nuk do të jetë e hapur për publikun.</p> <p>2. Përveç parashtruesit të kërkesës, gjatë procesit të intervistimit mund të jenë prezent edhe personat si në vijim:</p> <p>2.1. përfaqësuesi i autorizuar;</p> <p>2.2. përfaqësuesi ligjor për fëmijët e mitur;</p> <p>2.3. kujdestari ligjor për fëmijët e pashoqëruar;</p> <p>2.4. kujdestari për persona me aftësi të kufizuara mendore;</p> <p>2.5. përfaqësuesit e UNHCR-së dhe</p> <p>2.6. përkthyesi.</p>	<p>countries with which the applicant has any link;</p> <p>1.4. Identification of any missing information, and any unclear or incompatible information provided by the applicant, shall be clarified with him/her.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Participants in interview</b></p> <p>1. The interview with the applicant will be conducted under confidential conditions and will not be open to the public.</p> <p>2. In addition to the applicant, the following individuals may be present in the interview process:</p> <p>2.1. authorized representative;</p> <p>2.2. legal representative for minor children;</p> <p>2.3. legal guardian for unaccompanied children;</p> <p>2.4. caregiver for persons with mental disabilities;</p> <p>2.5. UNHCR representatives i</p> <p>2.6. interpreter;.</p>	<p>podnosilac zahteva ima bilo kakve veze;</p> <p>1.4. da utvrdi da li nedostaje bilo kakva informacija, odnosno da li je neka informacija koju je priložio podnosilac zahteva nejasna ili nespojiva, treba da se pojasni od strane podnosioca.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Učesnici u razgovoru</b></p> <p>1. Razgovor sa podnosiocem zahteva odvija se u uslovima poverljivosti i neće biti otvoren za javnost.</p> <p>2. Pored podnosioca zahteva, u procesu razgovora mogu biti prisutna sledeća lica:</p> <p>2.1. ovlašćeni zastupnik;</p> <p>2.2. zakonski zastupnik za maloletnu decu;</p> <p>2.3. zakonski staratelj za decu bez pratnje;</p> <p>2.4. staratelj za lica sa ograničenim mentalnim sposobnostima;</p> <p>2.5. predstavnici UNHCR-a i</p> <p>2.6. prevodilac.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Zhvillimi i intervistës</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>The interview with the applicant</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Razgovor sa podnosiocem zahteva</b></p>
<p>1. Me rastin e zhvillimit të intervistës, parashtruesi i kërkesës do të njoftohet nga zyrtari përgjegjës, për të drejtat dhe detyrimet në procedurë, sipas parimit të konfidencialitetit.</p> <p>2. Gjatë zhvillimit të intervistës do të mblidhen të dhëna lidhur me çështjet në vijim:</p> <p>2.1. identiteti i saktë i parashtruesit të kërkesës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes që e shoqërojnë atë;</p> <p>2.2. qëllimin e kërkesës për status të personit pa shtetësisë;</p> <p>2.3. mënyra e hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës dhe fakti nëse kanë parashtruar kërkesën për shtetësi apo për njohjen e statusit të personit pa shtetësi në ndonjë shtet tjetër;</p> <p>2.4. lidhja me ndonjë shtet tjetër, si: vendi i lindjes, prejardhjes së prindërve, vendbanimit, martesës, apo lindjes së fëmijëve të tyre.</p> <p>3. Përkthyesi nënshkruan deklaratën lidhur me konfliktin e interesit dhe ruajtjen e sekretit</p>	<p>1. On the occasion of the interview, the applicant will be notified by the case officer on rights and obligations during the proceedings, in accordance with the principle of confidentiality.</p> <p>2. During the interview, among other, information on the following issues will be collected:</p> <p>2.1. the exact identity of the applicant and of other accompanying family members;</p> <p>2.2. the basis of request for statelessness status;</p> <p>2.3. the manner of entry in the territory of the Republic of Kosovo and the fact whether has applied for citizenship acquisition or statelessness status in any other country;</p> <p>2.4. link to other country such as: place of birth, parents' place of origin, habitual residence, marriage, or the birth of their children.</p> <p>3. The interpreter will sign the statement regarding to the lack of conflict of interest and keeping of a</p>	<p>1. Prilikom obavljanja razgovora, odgovorni službenik upoznaće podnosioca zahteva sa njegovim pravima i obavezama u postupku, u skladu sa načelom poverljivosti.</p> <p>2. U toku razgovora, pored ostalog treba prikupiti podatke koji se odnose na sledeća pitanja:</p> <p>2.1.tačan identitet podnosioca zahteva i drugih članova porodice koji su u njegovoj/njenoj pratnji;</p> <p>2.2.osnov zahteva za dobijanje statusa lica bez državljanstva;</p> <p>2.3.način ulaska na teritoriju Republike Kosovo i podatak da li su prethodno podneli zahtev za sticanje državljanstva ili statusa lica bez državljanstva u nekoj drugoj državi;</p> <p>2.4.veza sa nekom drugom državom, kao što su: mesto rođenja, poreklo roditelja, prebivalište, sklapanje braka ili rođenja njihove dece.</p> <p>3. Prevodilac je dužan da potpiše izjavu da nije u sukobu interesa i da će čuvati profesionalnu</p>

<p>profesional sipas shtojcës 2.</p> <p>4. Gjatë zhvillimit të intervistës me parashtruesin e kërkesës mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga parashtruesi i kërkesës dhe zyrtari përgjegjës për të konfirmuar vërtetësinë pasi që t'i jetë komunikuar në gjuhën të cilën ai e kupton, si dhe nga pjesëmarrësit e tjerë në intervistë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Informatat nga vendi i origjinës</b></p> <p>1. Gjatë zhvillimit të procedurës mblidhen informata nga vendi i origjinës, përmes të cilave zyrtari përgjegjës do të njoftohet lidhur me situatën politike, sociale, kulturore, ekonomike, situatën e të drejtave të njeriut, legjislacionin e aplikueshëm për rregullimin e çështjes së shtetësisë në vendin e origjinës të parashtruesit të kërkesës.</p> <p>2. Zyrtari përgjegjës i referohet shteteve me të cilat parashtruesi i kërkesës ka lidhje të mundshme të shtetësisë:</p> <p>2.1. shtetit të lindjes;</p> <p>2.2. shtetit në të cilin personi e ka pasur vendbanimin e fundit;</p> <p>2.3. shtetit, apo shteteve të shtetësisë së prindërve;</p>	<p>professional secret in accordance with the annex 2.</p> <p>4. During the interview with the applicant all findings will be documented in a record, which will be signed by the applicant and the case officer, to confirm the authenticity, after being communicated in a language he/she understands, as well as by other participants in the interview.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Information from the country of origin</b></p> <p>1. During the procedure, the information from the country of origin will be collected, through which the officer in charge shall be informed of the political, social, cultural, economic, human rights situation, applicable legislation for regulating citizenship matters in the country of origin of the applicant;</p> <p>2. The case officer shall refer to countries with which the applicant has possible citizenship link:</p> <p>2.1. country of birth;</p> <p>2.2. country of person's last habitual esidence;</p> <p>2.3. country or countries of citizenship of parents;</p>	<p>tajnu prema aneksu 2.</p> <p>4. Tokom razgovora sa podnosiocem zahteva drži se zapisnik, koji potpisuju podnosilac zahteva i nadležni službenik da bi potvrdili njegovu autentičnost nakon što isti bude saopšten podnosiocu na jeziku koji on ili ona razume, kao i od strane drugih učesnika u razgovoru.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Informacije iz zemlje porekla</b></p> <p>1. U toku trajanja postupka, prikupljaju se informacije iz zemlje porekla, pomoću kojih se nadležni službenik upoznaje sa političkom situacijom, društvenim i ekonomskim stanjem, stanjem u oblasti kulture, ljudskih prava, kao i sa važećim zakonodavstvom koje uređuje pitanje državljanstva u zemlji porekla podnosioca zahteva.</p> <p>2. Nadležni službenik se obraća državama sa kojima podnosilac zahteva ima moguću povezanost sa državljanstvom:</p> <p>2.1. državom rođenja;</p> <p>2.2. državom u kojoj je lice imalo poslednje prebivalište;</p> <p>2.3. državom ili državama državljanstva roditelja;</p>
---	--	--

<p>2.4. shtetit të shtetësisë së bashkshortëve.</p> <p>3. Pas përfundimit të intervistës zyrtari i DSH - DSHAM nis procesin e verifikimit të shtetësisë së parashtruesit të kërkesës dhe nëse është e nevojshme merr informacione edhe përmes institucioneve relevante të përfaqësive të huaja diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare.</p> <p>4. Verifikimi me shtetin me të cilin parashtruesi i kërkesës ka lidhje apo ka pasur vendbanimin e fundit, në rastet e jashtëzakonshme afati do të zgjatet maximumi deri në dymbëdhjet (12) muaj.</p> <p>5. Mungesa e përgjigjes zyrtare, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, nuk do të ketë ndikim në vendimin përfundimtar të DSH/DSHAM-se.</p>	<p>2.4. country of citizenship of the spouse.</p> <p>3. After the interview, the DC/DCAM official initiates the process of verifying the citizenship of the applicant and if necessary, obtains information through relevant institutions of foreign diplomatic missions and international organisations.</p> <p>4. The verification with the country with which applicants has a link or had a last habitual residence will last in extraordinary situations maximum up to twelve (12) months.</p> <p>5. Lack of the official request within timeframe set in the paragraph 4 of this article will not have an impact on the final decision of DC/DCAM.</p>	<p>2.4. državom državljanstva bračnog druga.</p> <p>3. Posle obavljenog razgovora, službenik DD/DDAM pokreće postupak provere državljanstva podnosioca zahteva, i ako je potrebno dobija informacije i preko relevantnih institucija stranih diplomatskih misija i međunarodnih organizacija.</p> <p>4. Provera sa državom sa kojom predavalac zahteva ima vezu ili je imao/la zadnje mesto prebivališta trajaće u vanrednim slučajevima maksimalno do dvanaest (12) meseci.</p> <p>5. Izostanak službenog odgovora unutar vremenskog period utvrđenog u paragrafu 4 ovog člana, neće imati uticaj na krajnu odluku DD/DDAM.</p>
<p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI III</b> <b>NJOHJA E STATUSIT TË PERSONIT PA SHTETËSI</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Vendimi për njohjen e statusit të personit pa shtetësi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>CHAPTER III</b> <b>RECOGNITION OF THE STATUS OF STATELESS PERSON</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Decision on recognition of status of stateless persons</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE III</b> <b>PRIZNAVANJE STATUSA LICA BEZ DRŽAVLJANSTVA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Odluka o priznanju statusa lica bez državljanstva</b></p>
<p>1. Zyrtari përgjegjës shqyrton dhe analizon dëshminë e dhënë gjatë intervistës për të vërtetuar saktësinë e dëshmisë së dhënë dhe provave të ofruara gjatë procedurës, dhe përgatit një rekomandim përfundimtar në lidhje me</p>	<p>1. The case officer reviews and analyses evidences provided during the interview to confirm the accuracy of the testimony and the evidence provided during the proceedings and shall prepare a final recommendation on the</p>	<p>1. Nadležni službenik proučava i analizira dokaze date prilikom razgovora, da bi potvrdio tačnost izjave i dokaza ponuđenih u postupku, kao i da sačini završnu preporuku po zahtevu za priznavanje statusa lica bez državljanstva.</p>

<p>kërkesën për njohjen e statusit të personit pa shtetësisë.</p> <p>2. Pas analizimit të dosjes dhe provave nga paragrafi 1 i këtij neni, zyrtari përgjegjës përgatit rekomandimin drejtuar udhëheqësit të DSH dhe udhëheqësit të DSHAM dhe brenda periudhës kohore prej njëqindetëdhjetë (180) ditësh, i cili nxjerr vendim për aprovimin apo refuzimin e kërkesës për njohjen e statusit të personit pa shtetësi.</p> <p>3. Udhëheqësi i DSH-së dhe udhëheqësi i DSHAM-së, kanë të drejtë të ofrojnë rekomandime shtesë dhe ta kthej dosjen në rishqyrtim tek zyrtari përgjegjës në rast të mospajtitimit me rekomandimet e zyrtarit.</p>	<p>request for recognition of the status of stateless person.</p> <p>2. After analysing the file and evidence from paragraph 1 of this Article, the case officer prepares a recommendation to the Head of DC and Head of DCAM and within the period of one hundred eighty (180) days brings a decision on approving or rejecting the request for recognition of the status of stateless person.</p> <p>3. Head of DC and the Head of DCAM have the right to give additional recommendations and send the file back for re-evaluation to the case officer in case of disagreement with the recommendation provided by the officer.</p>	<p>2. Posle analize dosijea i dokaza iz stava 1 ovog člana, nadležni službenik sastavlja preporuku za rukovodioca DD i rukovodioca DDAM, i u roku od sto osamdeset (180) dana donosi odluku o usvajanju ili odbijanju zahteva za priznavanje statusa lica bez državljanstva.</p> <p>3. Rukovodilac DD i rukovodilac DDAM imaju pravo da daju dodatnu preporuku i da vrate dosije na ponovno razmatranje nadležnom službeniku u slučaju da se ne slažu sa preporukom tog službenika.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Vendimi lidhur me kërkesën</b></p> <p>1. Në pajtim me dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ DSHAM/DSH merr vendim lidhur me:</p> <p>1.1. njohjen e statusit të personit pa shtetësi apo</p> <p>1.2. refuzimin e kërkesës për statusin e personit pa shtetësi.</p> <p>2. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni ka për pasojë edhe fëmijët e mitur të tij/saj të cilët nuk</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Decisions regarding the request</b></p> <p>1. In accordance with the legal norms of this Administrative Instruction DCAM/DC brings decision linked with:</p> <p>1.1 recognition of the status of the stateless person;</p> <p>1.2 rejection of the request for the status of stateless person.</p> <p>2. The decision from the paragraph 1 of this article produce an effect on his/her minor</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Odluka po zahtevu</b></p> <p>1. U skladu sa pravnim normama ovog administrativnog uputstva DDAM/DD doneće odluku kojom:</p> <p>1.1. priznaje status lica bez državljanstva;</p> <p>1.2. odbija zahtev za priznanje statusa lica bez državljanstva;</p> <p>2. Odluka po stavu 1 ovog člana ima uticaj i na njegovu/njenu maloletnu decu koja nisu rođena</p>

<p>kanë lindur në teritorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Afati për nxjerrjen e vendimit sipas këtij neni është brenda njëqindetëdhjetë (180) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.</p> <p>4. Përjashtimisht rasteve të veçanta sipas nenit 12 paragrafi 4, afati nga paragrafi 3 i këtij neni mund të zgjatet edhe njëqindetëdhjetë (180) ditë tjera.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Dorëzimi dhe komunikimi i vendimit</b></p> <p>1. Në afat prej pesë (5) ditësh nga data e marrjes së vendimit, zyrtari përgjegjës obligohet t'ia dorëzojë dhe komunikojë vendimin me shkrim parashtruesit të kërkesës.</p> <p>2. Dorëzimi i vendimit bëhet në njërën nga gjuhët zyrtare kurse njoftimi për vendimin, palës i komunikohet në gjuhën të cilën parashtruesi i kërkesës e kupton.</p> <p>3. Në rastet kur parashtruesi i kërkesës ka përfaqësues të autorizuar, dorëzimi dhe komunikimi i vendimit do t'i bëhet përfaqësuesit të autorizuar.</p>	<p>children.</p> <p>3. The deadline for issuance of the decision is within a timeframe of hundred and eighty (180) days from the date of submission of application.</p> <p>4. Exception is made for specific cases in accordance with the Article 12 paragraph 4, when the deadline, from paragraph 3 of this Article can be exceeded for additional hundred and eighty (180) days.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Delivery and communication of decision</b></p> <p>1. In a period of five (5) days starting from the date of the decision taken on the request, the case officer will deliver and communicate the decision in writing to the applicant.</p> <p>2. The decision delivered in one of the official languages whilst the notification will be communicated in one of the languages that the applicant understands.</p> <p>3. In cases when the applicant has an authorised representative, the delivery and communication of the decision will be provided to the authorised representative.</p>	<p>na teritoriji Republike Kosova.</p> <p>3. Rok za donošenje odluke prema ovom članu je unutar stoosamdeset (180) dana od dana predavanja zahteva;</p> <p>4. Osim za specifične zahteve prema članu 12 paragraf 4, rok od paragraf 3 ovog člana se može produžiti dodatnih stoosamdeset (180) dana.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Dostavljanje i saopštavanje odluke</b></p> <p>1. U roku od pet (5) dana od dana donošenja odluke po zahtevu, nadležni službenik je obavezan da saopšti i dostavi pisanu odluku podnosiocu zahteva.</p> <p>2. Dostavljanje odluke se vrši na jednom od službenih jezika dok se saopštavanje odluke vrši na jednom od jezika koji podnosilac zahteva razume.</p> <p>3. U slučajevima u kojima podnosilac zahteva ima svog ovlašćenog zastupnika, istom se odluka saopštava i dostavlja.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Të drejtat e personit të cilit i është njohur statusi i personit pa shtetësi</b></p> <p>1. Personit të cilit i është njohur statusi i personit pa shtetësi ka të drejtë të:</p> <p>1.1. pajiset me dokumente të gjendjes civile me përjashtim të dokumenteve të shtetësisë;</p> <p>1.2. qëndroj në Republikën e Kosovës për të paktën një (1) vit me leje qëndrim të përkoshëm;</p> <p>1.3. pajiset me dokument udhëtimi për personat pa shtetësi.</p> <p>2. Të drejtat tjera janë të përcaktuara në Rregulloren për Integrimin e të Huajve.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b></p> <p style="text-align: center;"><b>The rights of the person with recognised status of the stateless person</b></p> <p>1. The person whose statelessness status was recognized has the right to:</p> <p>1.1. be provided with the documents of civil status, except the documents of citizenship;</p> <p>1.2. stay in the Republic of Kosovo for at least one (1) year with temporary residence permit;</p> <p>1.3. travel document for stateless person;</p> <p>2. Other rights derive from the Regulation for the Integration of Foreigners.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Prava lica kome je priznat status lica bez državljanstva</b></p> <p>1. Lice kojem je zvanično priznat status lica bez državljanstva ima sledeća prava:</p> <p>1.1. da dobije dokumenta građanskog statusa, izuzev dokumenta o državljanstvu;</p> <p>1.2. da boravi u Republici Kosovo najmanje jednu (1) godinu sa privremenom dozvolom boravka;</p> <p>1.3. Putnu ispravu za lica bez državljanstva;</p> <p>2. Ostala prava proizlaze iz Uredbe o integraciji stranaca.</p>
